



Tetor 2013

Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjituni!

Forumi Rajonal i Feministëve të Reja 2013 13-14 Nëntor, Hotel Sirius, Prishtinë (vetëm me ftesa)

Në këtë numër

Takimi Vjetor u Jep Energji dhe Fuqizon Anëtarët e RrGGK.....2

Avokimi Luan Rol Kyç në Fuqizimin e Vajzave.....3

OPDMK Shënon Muajin e Mundësive të Barabarta.....3

OJQ "Krusha e Vogël" Fuqizon Ekonomikisht Gratë në Zonat Rurale.....4

QKRMT Shënon Ditën Botërore të Shëndetit Mendor4



[Faqja në Facebook](#)



[Lista e dërgesave të E-Lajmeve](#)

Jeta-Vita Marshon për Vetëdijësim lidhur me Kancerin e Gjirit

Sheshi i qytetit të Prishtinës kishte marrë ngjyrë rozë. Pemët në qytet ishin mbështjellur me fjongo ngjyrë rozë dhe qindra qytetarë ishin pajisur me fjongo e shalle rozë, për të përkrahur gratë që vuajnë nga kanceri i gjirit. Së bashku, ata përcillnin një mesazh shumë të fortë që: ato nuk janë vetëm.

Sikurse edhe vitet tjera, edhe këtë vit Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta-Vita, me 12 Tetor mblodhi qytetarët pranë Teatrit Kombëtar. Pas një programi informativ dhe kulturor, ata marshuan së bashku me moton: "Zbulimi i Hershëm = Mbijetesë".

Këtë aktivitet Jeta-Vita e ka bazuar në suksese të mëhershme, duke kërkuar bashkëpunim më të mirë me institucionet e Kosovës në diagnostifikimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit.

"Ne nuk po kërkojmë mëshirë," tha Nafije Latifi, Drejtoreshë Ekzekutive e Jeta-Vita. "Ne nuk po kërkojmë diçka të pamundur. Ne vetëm po kërkojmë trajtim kualitativ dhe zbulim të hershëm të kancerit të gjirit. Kjo sëmundje nuk prekë vetëm gratë, por të gjithë familjen dhe shoqërinë."

Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga përkrahu iniciativën. "Ju lus të gjithave: nëna, gra, motra dhe vajza që t'i nënshtroheni kontrollave të rregullta mjekësore sepse zbulimi i hershëm do të thotë fitore mbi sëmundjen e kancerit të gjirit," tha ajo. "Përmes ecjes sonë simbolike, ne dëshmojmë kujdesin dhe solidaritetin si individë, si shoqëri dhe institucione, për të gjithë të prekurit nga kanceri i gjirit. Vetëm së bashku mund ta fitojmë këtë betejë."

Përfaqësues të tjerë të lartë shtetëror gjithashtu shprehën solidaritetin e tyre me personat që vuajnë nga kanceri i gjirit, duke ofruar përkrahjen e tyre.

Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga marshon së bashku me OJQ Jeta-Vita, për të promovuar zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.



Takimi Vjetor u Jep Energji dhe Fuqizon Anëtarët e RrGGK

Më shumë se 100 anëtare të RrGGK u mblodhën në Durrës të Shqipërisë, prej 3 deri me Tetor për një fundjavë çlodhëse, plot debat, argëtim dhe mësim. Pavarësisht nga agjenda e ngjeshur, pjesëmarrëset me plot energji vazhduan diskutimet edhe jashtë aktiviteteve të organizuara. Anëtare të ndryshme me gatishmëri ndanë njohuritë dhe përvojat e jetës së tyre, duke motivuar dhe inspiruar njëra-tjetrën.

"Një nga pikat e forta të RrGGK është diversiteti i saj," vuri në pah Lina Andeer, përfaqësuese e [Kvinna till Kvinna](#), organizatë suedeze që e mbështeti takimin. "Ju keni vajza dhe gra. Ju keni gra nga qytetet dhe nga zonat rurale, nga komunitete të ndryshme etnike dhe gra me aftësi të kufizuara."

Me të vërtetë, larmia e anëtareve të RrGGK, pjesëmarrëse në këtë takim, ishte frymëzuese. Gjatë fundjavës, ato mbështetën njëra-tjetrën: RrGGK kishte përkthim të vazhdueshëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, si dhe në gjuhën e shenjave. E kur filloi ahengu, të gjitha anëtarët u gjendën në pistën e vallëzimit, duke përfshirë edhe gratë e verbëra dhe personat me nevoja të veçanta fizike që vallëzonin në karriget e tyre me rrota.

Gjatë një punëtorie një-ditore të mbajtur mbi zgjidhjen e konflikteve, aktivistja frymëzuese e njohur botërisht, Shqipe Malushi mbështeti anëtarët me strategji të ndryshme për transformimin e energjisë negative në energji pozitive. Nga frika se ajo mund të hapë plagët që shumë gra ende i vuajnë që nga përfundimi i luftës, ajo u përcollti atyre me kujdes informatat se si të menduarit pozitiv mund të mbështesë gratë për të përballuar realitetin e tyre të përditshëm.

Të menduarit pozitiv mund t'i mundësojë aktivisteve që të kapërcejnë forma të ndryshme të konflikteve, nga ndërpersonale tek organizative tek shoqërore. Pjesëmarrëset mirëpritën qasjen e saj unike dhe strategjitë efektive të komunikimit.

"Kjo ishte një punëtori shumë pozitive dhe frymëzuese," tha një pjesëmarrëse.

Ndërkaq, në dhomën tjetër, Nicole Farnsworth, Menaxhere e Programit në RrGGK, udhëhoqi një diskutim tjetër lidhur me hapat konkretë të planifikimit të një iniciative efektive avokuese. Anëtarët diskutuan mjetet dhe "mënyrat" e planifikimit lidhur me procesin e avokimit. Pastaj, ato u ndanë në grupe ku planifikuan iniciativa avokuese për të adresuar çështje reale brenda komuniteteve të tyre, të tilla si qasja fizike në ndërtesat publike për personat në karroca, nënat me karroce për fëmijët dhe të moshuarit; sigurim shëndetësorë për të gjithë; dhe pensione të mjaftueshme për pensionistët.

"Punëtoritë për avokim ishte shumë produktive, sidomos të punuarit në grupe ku ne kishim mundësi të krijojmë strategji konkrete të avokimit," tha një aktiviste. "Shumica nga ne planifikojmë të përdorim këto strategji kur të kthehemi në Kosovë."

Përveç punëtorive të organizuara gjatë ditës, takimi përfshiu edhe ngjarje të ndryshme të mbajtura secilën natë. OJQ ["Artpolis"](#), moderoi një diskutim mbi "Fuqizimin e Grave." Anëtarët shikuan një seri të fotografive që shkaktuan emocione të ndryshme, të cilat pastaj anëtarët i diskutuan së bashku. Anëtarët e RrGGK gjithashtu mirëpritën mysafirë nga OJQ ["Gruaja tek Gruaja"](#) nga Shqipëria, të cilat argëtuan gratë me një monolog të fuqishëm dhe humoristik: "Sex. Faleminderit, thjeshtë sa për ta provuar."

Në mbrëmjen e radhës, aktivistet nga Shqipëria Delina Fico dhe Xheni Karaj, u bashkuan me anëtarët në diskutimin e kuptimit, koncepteve dhe praktikave të feminizmit në Kosovë dhe Shqipëri.

"Ka shumë njerëz të cilët nuk kanë njohuri lidhur me feminizmin," tha Delina Fico. "Ata thonë se feministët i urrejnë burrat, por feminizmi kurrë nuk i ka parë burrat si armiq. Në vend të kësaj, i ka parë ata si pjesë e problemit dhe e zgjidhjes. Kjo shihet qartë nga fakti se në të gjithë botën, edhe në Kosovë, ka burra feministë të cilët janë pjesë e projektit të rishikimit dhe reformimit të marrëdhënieve gjinore". Anëtarët e RrGGK pastaj diskutuan rëndësinë e feminizmit si pjesë e aktivizmit të përkrahjes së mëtuqeshme të të drejtave të grave.

RrGGK shënoi fundin e kësaj fundjave të paharrueshme me një aheng të mbushur me muzikë, argëtim dhe vallëzim.

"Ahengu ishte mënyra më e mirë për t'i dhënë fund këtij takimi. Ne me të vërtetë u argëtuam," tha një aktiviste.

Vallëzimi vazhdoi në autobus, gjatë gjithë rrugës për në Kosovë. Takimi i kishte shërbyer qëllimit të tij: të transformonte energjinë negative në energji pozitive, motivimin e aktiveve, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve dhe ofrimin e strategjive të reja për punën e ardhëshme të anëtareve.



Anëtarët dhe stafi i RrGGK mblidhen në fund të takimit të mbajtur në Durrës të Shqipërisë më 3-6 Tetor.

Avokimi Luan Rol Kyç në Fuqizimin e Vajzave

Iniciativa për Fuqizimin e Vajzave (IFV) përkrahë vajzat në zhvillimin e aftësive të tyre dhe që të marrin përsipër udhëheqjen e çështjeve që i brengosin ato.

Iniciativa angazhon vajza nga e gjithë Kosova që të bëhen katalizatorë të ndryshimit dhe të mobilizojnë edhe moshatarët e tyre që të bëjnë të njëjten gjë.

Në Gjakovë, me 24 Shtator vajzat ndanë sfidat me të cilat ato përballen: betejën lidhur me burimet e kufizuara, mungesën e vendeve të punës dhe diskriminimin sistematik që i bëhet thjeshtë vetëm pse janë vajza.

“Si vajza ne kemi opsione të limituara për tu shprehur pa u gjykuar nga të tjerët,” tha një vajzë nga Gjakova.

Për të adresuar këto sfida, vajzat nga Gjakova po zhvillojnë mënyra inovative dhe efektive për të përmirësuar jetërat e tyre.

“Ne mund të fuqizojmë njëra-tjetrën përmes aksioneve në rrugë dhe artit,” tha njëra nga vajzat. “Ne do të bashkojmë gra e vajza që të shprehin talentet e tyre.”

IFV gjatë muajit Tetor poashtu mbajti takime edhe në Prishtinë dhe Mitrovicë. Ato krijuan plane të veprimit për të adresuar çështjet me të cilat ato ballafaqohen. Vajzat nga Prishtina vendosën që të përgatisin një shfaqje teatrale, për të ngritur vetëdijen për rëndësinë e edukimit për vajzat. Ato poashtu planifikojnë të organizojnë një ecje paqësore në Sheshin Nëna Terezë.

Në Mitrovicë, vajzat planifikojnë të mbajnë takime me vajzat nëpër shkolla fillore dhe të mesme, për të ngritur vetëdijen e tyre lidhur me rëndësinë e edukimit. Duke u takuar direkt me to, vajzat besojnë që do të kenë ndikim të madh.

“Përveç që kemi kaluar shumë mirë, ne poashtu kemi mësuar shumë gjëra të reja,” tha një vajzë aktiviste. “Takimet e këtij lloji janë shumë të nevojshme për ne.”

Këtë vit, Iniciativa për Fuqizimin e Vajzave ka përfshirë 146 vajza nga e gjithë Kosova. Me përkrahjen e RrGGK, ato planifikojnë që gjatë vitit 2014 të implementojnë planet e tyre të veprimit. RrGGK dëshiron të fuqizojë më shumë vajza që të përfshihen në organizim dhe avokim për të drejtat e grave, duke forcuar në këtë mënyrë lëvizjen e grave në Kosovë. Iniciativa përkrahët nga Kvinna till Kvinna.



Një vajzë pjesëmarrëse në takimin e IFV në Prishtinë prezanton planin e punës të grupit të saj.

OPDMK Shënon Muajin e Mundësive të Barabarta

Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK) me 22 Tetor, në Prizren hapi një ekspozitë të fotografive të krijuara nga personat me nevoja të veçanta. Fotografistët përfshinin pjesëmarrësit e kursit për fotografi profesionale të organizuar nga OPDMK.



Personat me nevoja të veçanta ekspozojnë fotografitë e tyre në ekspozitën e organizuar nga OPDMK më 22 Tetor në Prizren.

Gjatë ekspozitës, OPDMK shënoi muajin Tetor si Muajin e Mundësive të Barabarta. Ekspozita u përkrah nga OSBE dhe Komuna e Prizrenit. OPDMK poashtu prezantoi punë të tjera të kryera nga personat me nevoja të veçanta.

Zyrtarë të ndryshëm nga komuna, qeveria dhe organizatat ndërkombëtare që ndihmuan në organizimin e kësaj ngjarje thanë fjalën e tyre.

“Duke i pasur të pranishëm këta persona, ne duam të vëmë në pahë rëndësinë e mundësive dhe të drejtave të barabarta për personat me nevoja të veçanta,” tha një ndër organizatorët e OPDMK.

OJQ “Krusha e Vogël” Fuqizon Ekonomikisht Gratë në Zonat Rurale

Anëtarët e OJQ “Krusha e Vogël” shprehën interesin e tyre për të vizituar organizata që merren me bujqësi nëpër komunat tjera.

Ato vizituan “Qendrën e Fidaneve” në fshatin Koretin të Komunës së Kamenicës. Vizita u bë me 23 Korrik, me përkrahje të Grupit Lokal të Veprimtimit (GLV).

“Kjo vizitë ka për qëllim të përkrahë shkëmbimin e përvojave dhe të mësuarit në fushën e bujqësisë,” tha njëra ndër themelueset e OJQ Krusha e Vogël.

Skender Dervishi dhe Ibrahim Bunjaki, pronarë të kompanisë së fidaneve i mirëpritën gratë. Ata u shpjeguan grave se si e zhvillojnë biznesin e tyre, çfarë fidane kultivojnë dhe detaje të tjera. Ata poashtu organizuan edhe një koktel për delegacionin e Krushës së Vogël. Gratë në këtë mënyrë patën mundësinë të shohin punë konkrete lidhur me atë se si të organizojnë më mirë mbjelljen e fidaneve, si dhe të shohin lloje të reja të fidaneve që nuk i kishin parë më herët.

Pas vizitës së tyre, anëtarët e OJQ Krusha e Vogël udhëtuan për në shtëpi duke përdorur një rrugë ndryshe prej asaj nga kishin ardhur dhe kaluan nëpër malet e bukura të Prevallës. Për shumë gra, ishte hera e parë që ato po shihnin këto male apo edhe që po udhëtonin vetëm me gra të tjera. Përvoja e tyre nuk ishte vetëm edukative, por edhe fuqizuese.

“Trajnimet kanë qenë shumë të rëndësishme për ne,” tha njëra nga anëtarët. “E kjo vizitë ishte diçka shumë e mirë dhe e re për ne. Ne kaluam shumë mirë; dolëm nga rutina jonë e zakonshme dhe mësuam shumë gjëra të reja.”

Të gjitha gratë anëtare të OJQ Krusha e Vogël ishin të përfshira në projektin “Fuqizimi Ekonomik i Grave në Zona Rurale” të përkrahur nga [Fondi i Grave të Kosovës](#) i RrGGK (financuar nga [Austrian Development Agency](#)). Ato vijnë nga fshatra të ndryshme si Hasi, Krusha e Vogël, Randobrava, Pirana dhe Serbica.



Gratë anëtare të OJQ “Krusha e Vogël” vizitojnë “Qendrën e Fidaneve” në Koretin të Kamenicës gjatë vitit 2013.

QKRMT Shënon Ditën Botërore të Shëndetit Mendor

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) shfaqti dokumentarin “Thirrje për Ndhimë”, një dokumentar i përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me personat me aftësi të kufizuara mendore.

QKRMT organizoi shfaqjen e dokumentarit për të shënuar 10 Tetorin, Ditën Botërore të Shëndetit Mendor. Dokumentari poashtu lidhet me fushën e veprimtarisë së QKRMT: parandalimin e torturës dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

QKRMT shfaqti dokumentarin më 22 Tetor në Institutin Special në Shtime, duke shfaqur në këtë mënyrë mbështetjen për rezidentët e këtij institucioni të shëndetit mendor.

“Qëllimi i këtij aktiviteti është promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të aftësive punuese të Personave me Aftësi të Kufizuara Mendore, me Sëmundje Psikiatrike dhe me Prapambetje Mendore, si dhe dëshira e vullneti i tyre për tu marrë me aktivitete të lira,” tha Feride Rushiti, Drejtoreshë Ekzekutive e QKRMT-së.

Në këtë ngjarje morrën pjesë përfaqësues të ndryshëm të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

“Ishte shumë ide e mirë që dokumentari të shfaqet në Institutin Special në Shtime, sepse në këtë mënyrë përfaqësuesit e qeverisë, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile patën rastin të shohim ambientet brenda institutit dhe kushtet e mira që ata ofrojnë për rezidentët e këtij institucioni,” tha Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGGK.

Dokumentari u krijua në bashkëpunim me Institutin Special në Shtime dhe u mbështet nga Civil Rights Defenders. QKRMT është [organizatë anëtare](#) e RrGGK-së.

Na tregoni edhe neve se pse jeni Feministe!

Postoni fotot & arsyet këtu.



"Unë jam feministe sepse dua të luftoj kundër seksizmit dhe për liri."

- Fjolla Vukshinaj